



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 7.1 pika (a) dhe (b), 7.2, 8.6 dhe 64.2 pika (g) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe duke u bazuar në vendimin e PZAP-së, nr. ZL.Anr.1114/2017, si dhe vendimin e Gjykatës Supreme AA.nr.55/2017 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 11.12.2017, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve për Përsëritja e Raundit të Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar Komune në Istog 17 Dhjetor 2017

- I. Certifikohet Lista Përfundimtare e Votuesve për përsëritja e Raundit të Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar Komune në Istog, që do të mbahen më 17 dhjetor 2017.
- II. Lista Përfundimtare e Votuesve sipas këtij vendimi është publike, dhe do të shpallet në ueb-faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Raporti i Divizionit të Shërbimit të Votueseve për Listën Përfundimtare të Votuesve si në pikën I të këtij vendimi.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me datë 11 dhjetor 2017.

Prishtinë, 11.12. 2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Zgjedhjet Lokale

Përsëritja e Raundit të Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar Komune në Istog

17 Dhjetor 2017

Lista Përfundimtare e Votuesve

2017

PËRMBAJTJA

QËLLIMI.....	3
PËRMBLEDHJE.....	3
VOTIMI JASHTË KOSOVËS.....	4
PËRMBLEDHJE TABELORE (Numri i votuesve, numri i QV, numri i VV dhe numri i votuesve për qendra të votimit).....	5
(Numri i votuesve për qendra të votimit dhe numri i vendvotimeve për qendra të votimit).....	5

Qëllimi

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është e obliguar që të certifikoj listën e votuesve në raport me zgjedhjet e caktuara¹.

Përmbledhje

Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV 2017) për Zgjedhjet Lokale është bazuar në Ekstraktin e Regjistrimit Qendror Civil². Ky ekstrakt është përpiluar nga Agjencia e Regjistrimit Civil, gjegjësisht Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve (DPA), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

I. Lista Përfundimtare e Votuesve 2017 për Zgjedhjet e Lokale për komunën e Istogut ka përbajtur³:

- **47,683** emra të votuesve.

Bazuar në vendimin e PZAP-së, nr. ZL.A.nr. 1114/2017, si dhe vendimin e Gjykatës Supreme AA. Nr. 55/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e mbajtur me datën 02.12.2017, ka nxjerrë vendim për miratimin e propozimit për votim jashtë Kosovës, për përsëritjen e votimit për kryetar Komune në Istog⁴.

Përgjatë periudhës së caktuar në bazë të vendimin të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (Vendimi Nr. 2415-2017, i datës 02.12.2017) 2 dhjetor 2017 deri më 6 dhjetor 2017: gjithsejtë kanë dërguar email, në email-at zyrtar të Operacionit të Votimit përmes Postës, 90 votues:

- 85 votues që janë regjistruar suksesshëm përgjatë Periudhës së Aplikimit për Regjistrim (16.07.2017 – 23.08.2017) kanë dërguar dëshmi zyrtare për adresën e vendbanimit jashtë Kosovës dhe janë konfirmuar përmes telefonit, dhe
- 5 votues nuk kanë dërguar kopje të dëshmisë për adresën e vendbanimit.

¹ Ligji Nr. 03/L-256, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 64.2, pika (g).

² Ibid, Neni 7.1, pika (a) dhe (b).

³ Zgjedhjet Lokale 22 tetor 2017 dhe Raundi i Dytë i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Istogut.

⁴ Vendimi Nr. 2415-2017, i datës 02.12.2017 Për Miratimin e Procedurës për Verifikimin dhe Konfirmimin e Votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Përsëritura për Raundin e Dytë për Kryetar Komune në Istog.

Në bazë të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (Vendimi Nr. 2415-2017, i datës 02.12.2017) pika IV: Votuesit e regjistruar jashtë Kosovës përgjatë datës 16.07.2017 deri 23.08.2017, të cilët nuk do të konfirmojnë adresën dhe numrin kontaktues, do të kthehen si votues në listën e votuesve brenda Kosovës, sipas adresave në Regjistrin Qendror Civil.

Në bazë të kësaj, numri total i votuesve në Listën Përfundimtare të Votuesve brenda Kosovës, për Përsëritjen e Zgjedhjeve të Raundit të Dytë për Kryetar Komune në Istog 17.12.2017, është:

- a) 49,150 emra të votuesve
 - 1,467 emra të votuesve më shumë në listën përfundimtare të votuesve brenda Kosovës për komunën e Istogut.

Votimi jashtë Kosovës

Për Zgjedhjet Lokale të datës 22 tetor 2017, për komunën e Istogut suksesshëm kanë aplikuar për regjistrim 1,587 votues.

Ndërsa, përgjatë periudhës së verifikimit dhe konfirmimit për votuesit jashtë Kosovës për Zgjedhjet e përsëritura për raundin e dytë për Kryetar Komune në Istog, që do të mbahen me datën 17.12.2017, përgjatë periudhës prej 2 dhjetorit 2017 deri më 6 dhjetor 2017, prej 1,587 votuesve:

- a) 85 votues që janë regjistruar suksesshëm përgjatë Periudhës së Aplikimit për Regjistrim (16.07.2017 – 23.08.2017) kanë dërguar dëshmi zyrtare për adresën e vendbanimit jashtë Kosovës dhe janë konfirmuar përmes telefoni.
- b) 1,467 votues që kanë qenë të regjistruar suksesshëm përmes postës dhe që janë hequr nga lista përfundimtare e votuesve⁵ për Zgjedhjet Lokale 2017, janë kthyer prape në listën e votuesve brenda Kosovës, në vendvotime.
- c) 35 votues që kanë qenë në Listën e votuesve jashtë Kosovës janë votues që nuk kanë qenë shtetas të Republikës së Kosovës në Regjistrin Qendror Civil, por që kanë pas të drejtë shtetësie dhe të cilët e kanë dëshmuar këtë të drejtë përgjatë periudhës së aplikimit për regjistrim.

⁵ Rregulla Zgjedhore Nr. 03/2013 Votimi jashtë Kosovës, neni 3.8.

Përmbledhje tabelore

1. Numri i votuesve, Numri i Qendrave të Votimit dhe Numri i Vendvotimeve për komunat e Republikës së Kosovës.

Nr.	Komunat	Numri i Votuesve	Numri i Qendrave të Votimit	Numri i Vendvotimeve
06	Istog	49,150	23	63
	TOTAL	49,150	23	63

2. Numri i votuesve për qendra të votimit dhe numri i vendvotimeve për qendra të votimit.

Qendra Votimit	Numri Votuesve	Numri vendvotimeve
0601C	8423	10
0602C	6147	7
0603C	1469	2
0604C	4493	5
0605C	2333	3
0606C	4680	6
0607C	1584	2
0608C	1726	2
0609C	1278	2
0610C	808	1
0611C	277	1
0612C	1548	2
0613C	1101	2
0614C	697	1
0615C	674	1
0616C	633	1
0617C	1455	2
0618C	767	1
0619C	1858	2
0620C	2918	4
0621C	1234	2
0622C	1764	2
0623C	1283	2
23 Qendra të Votimit	49,150 votues	63 Vendvotime